

SERVIZIO SANITARIO REGIONALE  
EMILIA-ROMAGNA

Regione Emilia-Romagna

# Attenti a quei due!

Ose sigurimi i Femijve te vegjel



albanese

CAMPAGNA REGIONALE PER LA PREVENZIONE DEGLI INCIDENTI DOMESTICI

# Përmbledhje

- **Sa e vështirë është të rritesh me siguri** 4
- **Dhoma ime: bota ime** 6  
prizat, llampat dhe llampadinat e vogla për naten aparati për lageshtinë, foni i brendshëm, mobilia për veshjen e zhveshjen e femijve
- **Kuzhina: shumë gjëra të mira** 8  
sexholino, ngrohës biberoni, fërnella, elektriciteti, elektroshtepiake të vogla, furra, gazi, sirtaret dhe dollapet
- **Dhoma e ndenjes: sa pasione** 10  
sirtaret, televizori, kavot elektrike të jashtme llampa, kabllot elektrike, qoshet dhe xhamat, ballkoni
- **Banjo: tërheqje fatale** 12  
fon për floket, rubinetet, vaska e banjos, ilaçet
- **Në kopshte dhe jashtë shtëpise** 14  
karroca, vendi për biçikletën, triçikli dhe biçikleta, lodrat, vaskat dhe pishinat
- **Lodrat e sigurta** 16  
para blerjes, para se të përdoren, pas përdorimit
- **Bebi S.O.S.** 16  
shkarkimet elektrike, djegjet, helmimet, mbytja
- **Sigurimi është... të mos kondicionohesh nga stresi, parashikimi** 18
- **Për të parashikuar...** 18

*Mos e prek këtë, ki kujdes me këtë tjetrën,  
mos i fut në gojë gjërat, sa mërzitje  
Për mamin dhe babin shumë gjëra kanë qenë të ndaluara:  
por kanë qenë të mirë.  
Më kanë mësuar të jem i kujdesshëm  
dhe janë përpjekur të me mbajnë larg  
rreziqeve te shumta që fsheh shtëpia.*



# Ja vështirsi për tu rritur

**Por fillojmë nga fillimi.**

**Më quajnë Ale dhe jam një kurjuz i madh:** kur isha i vogël asgjë në shtëpi nuk më shpëtonte për kundrazi, më tërhiqte me shumë.

Kishte raste që isha me të vërtet diabolik: kurioziteti dhe mungesa e ndjenjës së rrezikut më çonin të bëja veprime të papritura që vinin në rrezik mbrojtjen e shëndetit tim.

Mami dhe babi janë lodhur shumë për të parashikuar çdo lloj rreziku, dhe vetëm sot që jam i rritur kuptoj sa të rëndësishme kanë qenë vërejtjet e tyre.

Në fillim Janë bërë që shtëpia të jetë e sigurt, kane përdorur aparate të rregullta, duke i vendosur në vëndet e duhura. Sigurisht nuk kanë mundur të mos përdorin objekte që të përdorura nga personat e rritur janë shumë të nevojshme, por në duart e fëmijve janë arma të rrezikshme.

Më shumë janë, thika vdekjeprurese, mortaja shkatërruese... më falni po e ekzagjeroj shumë.

Por faktikisht mami dhe babit u është dashur të marrin masat e duhura, më kanë ruajtur mirë, në shtëpi, kanë marrë të gjitha për siguresën dhe parashikimin e aksidenteve.

Tani edhe unë kam mësuar të jem i kujdesshem.

Me pëlqen tu tregoj fëmijve si unë dhe te "rriturve" kush janë masat e duhura për ta bërë shtëpinë sa më të sigurt.

# Attenti a quei due!



# Dhoma ime: bota ime

## *I shikoni këto vrimat e vogla dhe të çuditshme te muri?*

Janë prizat e korentit. Kur i pashë për herë të parë u mundova të futja gishtat brënda: dukeshin sikur ishin bërë me porosi. Por babi ishte mëparashikues se unë. Për të me ndaluar që të me ndodhte ndonjë gjëe keqe kishte vënë prizat të markës të sigurimit, ato që kanë Palete të brëndshme (kapaku siç i quan babai) që më ndalonte të fusja aty me majë që kisha nëpër duar.





# Attenti a quei due!

## • PRIZA E KORRENTIT

Vendosni priza korrenti me markën e sigurecës që te jenë të mbrojtura në mënyrë të tillë që evitojnë që fëmijët mund të fusin gjëra metalike dhe të rrezikojnë të marrin shkarkimin elektrik.

## • LLAMPAT E LLAMPADINAT E VOGLA

Për dhomën e fëmijëve ekzistojnë llampa lodre të lezetshme si forma dhe në gjuhën teknike quhen "aparate ndriçimi për mobilje tip lodre", të ushqyera me tension të ulët për sigurecën (12 Volt). Për natën zgjidhni llampadina të vogla kundër frikës: konsumon më pak se një Wat dhe futet direkt te priza elektrike.

## • APARATI PËR LARGESHTINË

Vihet mundësisht jashtë dhomës së fëmijës, sipër një sipërfaqe të fortë. Kujtohuni të ndërroni ujin çdo ditë për të evituar formimin e bakterieve dhe mikrobeve.

## • FONI I MBRËNDSHËM

Eshtë i formuar nga dy pjesë regjistron çdo zhurmë të vogël ose të madhe në dhomën e fëmijës dhe e trasmeton në dhomën e prindërve: fëmijët e juaj do të jenë nën kontroll dhe ju jeni të qetë.

## • MOBILIA PËR TË MBËSHËTETUR FËMIJËN GJATË VESHËS

Sipërfaqja duhet të jetë e fortë dhe e stabilizuar, e madhe me dimensione të paktën 60x60cm me materiale jo toksike dhe e lehtë për tu larë. Fëmija nuk lihet asnjëherë vetëm tek mobilia që përdoret për tu ndërruar. Ja sekretet për të mos thënë gjithmonë jo, kur dëshironi një lodër të re: zgjitni vetëm ato që janë të sigurt dhe të përshtatshme për moshën. Fjala e Ales.

## • LODRAT

Duhet të vihen në mënyrë që fëmija ta ketë të lehtë ti gjejë e të luajë. Lodrat elektrike: blini ato që janë të ndërtuara në konformitet me normat e sigurimit. Kujdes me lodrat ku është shkruar "të përdoren nën vëzhgimin e të mëdhenjve", respektoni rregullat. Kontrollat baterit që janë të vendosura: nëse janë të konsumuara mund të lëshojnë acide helmuese.

## • KREVATI

Duhet të jetë i fortë, i rrethuar me jastëk të butë e të mbushur. Spondet anësore duhet të jenë të larta të paktën 80 cm dhe distanca midis shufrave nuk duhet të tejkalojë 8 cm për të evituar që fëmija të fusi kokën.

## • JASTËKU

Nuk duhet të jetë as shumë i butë as shumë i madh, për të evituar rrezikun e mbytjes. Ekzistojnë në tregti jastëk në gomapiuma me kanale për ajrimin që japin mundësi që fëmija të marrë frymë edhe kur fle me barkun përmbys. Duhet të kihet parasysh që deri në një vjeç është mirë që fëmija të flejë nga ana e kurrizit.

## • RRJETA PËR MBROJTJEN NGA MUSHKONJAT

Në periudhën e verës për ti mbrojtur fëmijët nga pickimi i insekteve perdorni rrjetën kunder mushkonjave: mbrojnë fëmijën dhe garantojnë edhe penetrimin e dritës dhe ajrit.



# Kuzhina: sa gjera te mira

**Edhe sot këtu zhvillohet aktiviteti im i preferuar:**

*ushqimi, edhe se herët e para e kisha bezdi të rrija "lart" sipër atij "tronit" lart e lart kur ndërkohë të tjerët ishin të ulur në karrike të rehatshme dhe me te ulta, pa u lidhur me rripa sigurimi, të lirë të lëviznin kur të donin.*



**Këtu nuk mungon asgjë:**  
zjarri, uji, nxehtësia e furrës,  
zhurma e aparateve elektrike,  
spinat elektrike, kavot që  
mbështillen rreth vetes,  
sirtaret që hapen, tapat e  
shisheve që duhen zhvidhuar.  
Me të vërtete interesante për  
fëmijet e vegjel. Por mami im  
i kishte parashikuar të gjitha  
dhe i kishte siguruar.





# Atentni a quei due!

## • SEKËHOLONË

Edhe se ka një bazë të fortë për të evituar që të përmbysset dhe fëmija të rrëzohet, duhet të ketë edhe një mbështetëse për këmbët që nuk e lejon ta përdorë si mbështetëse për tu ngritur. Lidhe gjithmonë me rripin e sigurimit.

## • NGROHËSËN E BIBERONIT

Vini gjithmonë larg përdorimit të fëmijës. Kur e përdorni vërtetoni që niveli i ujit të jetë të paktën në minimum dhe rregulloni temperaturën e duhur. Vërtetoni gjithmonë temperaturën e qumshitt tek pjesa e lartë e dorës para se t'ja jepni për të pirë fëmijës.

## • FURNELLAT

Duhet ti mesoni fëmijët që të mos afrohen pranë furnellave të ndezura dhe të mos luajnë me botonet e gazit. Në përgjithësi preferoni kuzhinat me gaz me skerma mbrojtëse – që i pengon fëmijët të derdhin tenxheret – dhe vendosni dizpozitive mbrojtëse (termocoppie) që bllokojnë dalien e gazit kur shuhet flaka. Përdorni më shumë furnellat që janë më afër murit, që janë më larg për tu arritur nga fëmijet. Mos lini bishtat e tenxhereve o tiganëve jashtë.

## • ELEKTRICITETI

Mos lini asnjëherë aparatet elektrike në funksionim pa i ruajtur kur keni fëmijet afër. Mësoni fëmijet që të mos i prekin aparatet kur janë të nxehta sepse mund të digjen.

## • APARATE ELEKTRO SHTEPIAKE

Vërtetoni gjithmonë nëse janë të ndërtuara sipas rregullave të sigurimit dhe kujdeseni për mirëmbajtjen. Pas përdorimit mos i lini në prizë dhe vendosni me kujdes në vendet e përshtatshme duke pasur kujdes për fi llin elektrik. Zgjidhni aparate që kanë sisteme mbrojtëse dhe që bllokojnë pjesët lëvizëse kur ngrihet kapaku.

## • FURRA

Kini kujdes për xhamin e furres se mund të jetë shumë e nxehtë dhe mund të provokojë djegie. Sporteli nëse është il hapur mund të përdoret si shkallë edhe pse aparatet e fundit janë të ndërtuara sipas normave të sigurimit dhe e kanë kaluar provën që mund të përmbysen, duhet gjithmonë kujdes.

## • GAZI

Ku është një aparat që përdor gazin duhet të sigurohet një ambjent ajrimi. Për këte arsye duhet një hapësirë 10x10, që quhet edhe brima e ajrimit të përhershëm.

## • SIRTARE DHE DOLLAPE

Ilaci i rrobave, shkrepsat, thikat, gërsherat, dizinfektante, ilaci për mizat... nuk lihen në ambiente ku mund ti kapi dhe fëmija. Vendosni të gjitha në sirtare e dollape të bllokuara e të mbyllura që të mos hapen.

# Dhoma e ndenjës: sa pasione

## *Të hypesh sipër mobiljeve, ç'farë pasioni.*

Edhe pse mami dhe babi nuk më kanë çuar akoma në mal, hapja sirtaret e dollapeve dhe..., hypja sipër. Por babi i kishte parashikuar edhe këto gjëra. Edhe dhoma e ndenjës është një hapësirë për tu zbuluar. Ç'farë bënte ajo makina që flet e mbyllur dhe e fjetur?. Ishte me të vërtetë një tentacion: unë kërkova ta kapja te filli elektrik... Pastoj ndalova sepse mu kujtua babai që më thoshte "nuk bëhet sepse është e rrezikshme".





# Atentni a quei due!

## • SIRTARË

Duhet bllokuar me mjetin bllokues: sepse mund të transformohen si pedana për tu hipur dhe mund të rrëzohen sipër fëmijes.

## • TELEVIZORI

Nuk këshillohet për fëmijet e vegjël. Megjithatë duhet shikuar në një largësi të sigurt për të mos dëmtuar sytë (minimumi 5 here diagonalen e skermës televizive).

## • KAVOT E JASHTMË

Impiantet elektrike me kavot që janë jashtë, janë të ndaluara, sepse fëmijet mund të kapin dhe ti terheqin.

## • LLAMPAT

Kur digjet një llampë stakoni prizën kryesore. Mos e lini portallampën vetëm sepse fëmija mund të fusi gishtat dhe të marri shkarkimin elektrik.

## • FIJET ELEKTRIKE

Fijet esterior, televizorit, të videoregjistrimit nuk lihen të varura, por duhen të fshihen që të mos duken. Kini kujdes edhe për prizat që zgjasin sepse fëmijet mund të pengohen dhe të rrëzohen. Duhet evituar që të lidhen shumë aparate në të njëjten prizë; perdorni një prizë me shumë kontakte dhe qe ka markën e sigurimit.

## • INTERRUTTORE DIFFERENZIALE (KËNDROR QENDROR ELEKTRIK)

Instaloni një interrutore differenziale - i quajtur edhe "shpëtimi i jetës" - që mban "nën kontroll" impiantin elektrik.

## • QOSHËT DHE XHAMAT

Mbuloni të gjitha qoshet e mobiljeve me gomë. Siperfaqet dhe portat me xham mund të ruhen me një plastmas të hollë speciale e transparente: e ngjitur pas xhamit eviton nëse thyhet që pjesët e vogla mbeten të ngjitura te fleta plastike, dhe nuk rrezikohet që fëmija të pritret nga pjesët e thyera të xhamit.

## • BALLKONI

Nëse dhoma e ndenjës ka edhe një ballkon verifikoni që shufrat e hekurit që rrethojnë ballkonin të mos jenë horizontale se fëmija i përdor si shkallë për tu ngjitur dhe nëse janë vertikale duhen të jenë të ngushta që fëmija mos fusi kokën. Mirë është të vihet një rrjet e brendshme.

Verifikoni gjithmonë që afër murit të ballkonit të mos ketë karrike ose stola ose objekte që ndihmojnë fëmijen të hipi sepse është e rrezikshme. Kjo vlen edhe për dritaret.

# Banjo: terheqje fatale

***Në realitet kur isha në vaskë nuk lahesha por luaja me ujin.***

*Por duhet të kem kujdes. Mami më ka thënë gjithmonë që në banjo janë dy miq, uji dhe elektriciteti. Miq shumë të nevojshëm, por të përdorur së bashku transformohen në armiq të rrezikshëm që mund të dëmtojnë shumë. Atëhere një me rradhë: paktet e qarta dhe miqësia e gjatë.*





# Attenti a quei due!

## • FON

Është mirë që fon mos përdoret në banjo dhe sidomos larg vaskes, lavamanit, veçanërisht kur janë të mbushura me ujë. Mos i lini fëmijet që ti përdorin vetëm. Mësojini që të mos e përdorin me duart e lagura ose me këmbet zbatthur. Pasi i keni tharë flokët hiqeni nga spina.

## • RUBINETI

Rreziku është uji i ngrohtë që mund të provokojë djegie. Kontrolloni që temperatura e ujit mos jetë shumë e lartë.

## • VASKA E BANJOS

Nuk duhet të mbushet shumë. Për të evituar që fëmija të rrëshqasë përdorni një tapet kundër rrëshqitjes ose vini adezivin kundër rrëshqitjes. Vërtetoni gjithmonë temperaturën e ujit. Mos e lini fëmijen asnjëherë vetëm.

## • ILAÇET

Duhet vendosur jashtë mundësisë që fëmijet mund ti gjejnë, ne dollape të mbyllura dhe të bllokuara që të mos hapen.



# Në kopshte dhe jashtë shtëpisë

**Kur isha i vogël më çonin të tjerët jashtë në oborr dhe në kopshte të lidhur tek karroca si sallam.**

Në makinë dhe në biçikletë rrija gjithmonë i lidhur tek sexholino; rrugën gjithmonë e zgjithnin prindërit!

Në oborr ose në kopsht doja të luaja vetë por mami dhe babi ishin të vëmendshëm, kontrollonin shilarsin; me shoqeronin për të shikuar peshqit tek vaska dhe, kur fillova të përdorja biçikletën më vunë kaskën!





## • SEXHOLINO

Sexholinët janë të detyrueshme që nga viti 1988, duhet të jenë të homologuar dhe duhet të kenë etiketën që është konform rregullave CEE 44.03 ose 44.04. Për garantimin e sigurecës së fëmijes është e nevojshme përdorimi korrekt i sexholinos për të gjitha moshat dhe tapat e rritjes (deri në 36 kg të peshës dhe 150cm të lartësisë). Ekzistojnë 4 grupe të sexholinos: grupi 0 e 0 + (ovale klasike) vendosen në drejtimin e kundert të lëvizjes së makinës, pastaj është grupi I dhe II vendosen në të njëjtin drejtim të lëvizjes së makinës dhe ato të grupit III janë ato që përdoren me rripin e sigurimit të makinës dhe që e ngrejnë lartësinë e fëmijes. Nëse makina ka airbag sexholino duhet të vendoset tek sediljet mbrapa, që është gjithmone vendi më i sigurt për të vendosur sexholinon.

## • KARROÇA

Duhet të jetë e fortë, e stabilizuar me një sistem frenash të rregullta dhe me bllokimin e sigurt dhe efçente. Vërtetoni që mbyllja është e sigurt dhe rripat e sigurimit të lidhura.

## • SEXHOLINO PËR BIÇIKLETEN

Për të zgjedhur sexholinon e biçikletes zgjidhni atë që ka paisjen për vendosjen e kembëve anësore në mënyre që këmbet të mos hyjnë te rrotat e biçikletës dhe në mënyrë që këmbet fëmijes të rrinë drejt pa lëvizur. Për fëmijet më të vegjël ekzistojnë edhe sexholinot që vendoset përpara. Duhet gjithmonë të lidhen rripat e sigurimit.

## • TRIÇIKLI DHE BIÇIKLETA

Duhen të jenë të forta dhe me masen e duhur sipas moshës së fëmijes. Lejon që fëmijet të lëvizin vetëm në zona të mbrojtura si parqet, kopshtet dhe rrugët që janë të mbyllura nga trafiku. Fëmijve më të mëdhenj duhet të përdorin kaskën te koka me markën CE (Conformité Européenne) që çertifikon respektin e normave të sigurecës europее.

## • LOJRAË

Para se ti hipni fëmijet te shilarsi te rreshqitsi o lodrat te parku kontrolloni që struktura e mbështetjes të jetë e fortë, që rreshqitsi të ketë të dy anësoret dhe lodrat që rrotullohen te kenë zinxhirin e sigurecës dhe mekanizmin rrotullues.

## • VASKA DHE PISHINA

Fëmijët mund të mbyten edhe me pak centimetra uji. Në rastin e pishinave plastike, edhe se leveli i ujit është i pamjaftueshem, duhet që fëmija të jetë gjithmonë në vëzhgim. Pas përdorimit mos lini vaskën ose pishinën me ujë dhe kontrolloni që te mos ketë lodra brënda që fëmijet të hyjnë brënda dhe të luajnë vetem. Pishinat duhet të jenë gjithmone të mbyllura me kopertinë ose me kançelin e mbyllur kur nuk përdoren.

## Lodrat e sigurta

Të gjithë lodrat duhet të kenë markën CE, duhet të jenë prodhuar me material jo toksik dhe nuk duhen të jenë me materiale që marrin zjarr lehtë. Para se ti blini kontrolloni gjithmonë që mosha e fëmijes korrispondon me indikacionin që shkruhet per perdorimin e lodrave dhe kujdes per perdorimin. Pas përdorimit, verifikoni gjithmonë gjendjen e lodres: nese është i dëmtuar ose i prishur ose ne rast se dyshoni per sigurecen, riparojeni ose e hidhni e mos e përdorni.



## Bebi S.O.S.

### Shkarkimi elektrik

Në rast shkarkimi të lehtë rrjedhojat janë: trëmbja e fëmijes dhe skuqja e pjesës së lekurës që është në kontakt me korrentin. Lageni me ujë të ftohtë dhe mjekojini me garza sterile dhe pomada kunder djegies. Nëse fëmija ngelet "i ngjitur" me prizën e korrentit, duhet ta tërhiqni me forcë menjëherë, ose më mirë me një baston druri për të evituar që edhe ju të rринi i ngjitur me korrentin, nëse priza është afër mbylleni menjëhere.

Nëse djegia është e thellë dhe fëmija prezanton shenjat e një shoku (djersitje, pulsim i shpejtë, vjellje) duhet të çohet menjëhere te urgjenca.





# Attenti a quei due!

## Djegia

Nëse fëmija i vogël digjet pak ose lehtë lagjeni djegien me uje të ftohtë, e ftohta e anestetizon dhe pengon formimin e fluskave. Pastaj lyjeni pjesën e djegur me pomade kunder djegies. Nëse djegia është e rëndë mos i hiqni rrobat që ka në trup - sepse vështirsoni më shumë situatën - por e lagni dhe ftohni me uje të ftohtë pjesën e dëmtuar dhe çojeni te urgjenca në spital. Mos përdorni në asnjë mënyrë vajin ose prodhime vajore.



## Helmimi

Vihuni në kontakt menjëhere me qendrën kunder helmimit që është më afër dhe komunikoni moshën, peshën e fëmijes dhe informacione për sostancën që ka pirë.



## Mbytja

Nëse fëmija ka gëlltitur një copë duhet të hiqet nga fyti. Në rast se fëmija është shume i vogël, vëreni në pozicion te krahet e juaja me barkun poshtë (koka e mbështetur tek dora e juaj) dhe i bini te kurrizi goditje të drejtura përpara në mënyre që ta ketë të lehtë të nxjerri objektin që ka gëlltitur. Nëse është më i madh vëreni midis gjurit me kokën poshtë duke i mbajtur kraharorin, dhe goditeni te kurrizi midis brinjëve.

## Figuresa është... te mos kondicionohesh nga stresi

Stresi, preokupimi, vështirësi psikologjike, por edhe gjendja shpirtërore euforike, mund të shkaktojnë pavëmendje dhe nënlehtësi e sjelljeve korrekte.

Është e lehtë të vritesh nëse:

- je e lodhur ose e çituar nga shume pune
- nëse je me ankth
- nëse nënvlersohet rreziku sepse ndihesh i sigurt.

## Për të parashikuar

**Mësoni ti jepni rëndesi** gjërave që do bëni duke rispektuar nevojat e juaja.

Lodhja dhe punët e ekzagjeruara nuk janë shokë të mirë për kualitetin e jetes.

**Ndaloni dhe mendohuni. Ankthi kondicionon dhe ndërhyt në jetën tuaj.**

## Për të parashikuar... Mbytjet dhe helmimet


- **Lexoni me vëmendje** etiketat e ambalazhimit të lëngjeve me simbolet e rrezikut dhe lexoni shpjegimet për përdorimin e prodhimit për pastrimin dhe higjienen.
- **Mos blini prodhime** që nuk kanë etiketen e shpjegimeve për përdorim edhe pse kushton më pak.
- **Mos i transferoni prodhimet** që janë të rrezikshme në shishe të tjera që janë të ndryshme nga origjinali dhe pa etiketë.
- **Përdorni gjithmonë doreza** për të mbrojtur duart.

## Për të parashikuar... Zjarri

- Mos i lini perdet afër kaldajes, stufës, dhe fërnellave.
- Mbani në vend të sigurt alkolin dhe trielina.
- Mos u afroni afër stufës me gaz me rrobat që ju varen ose që janë sintetike (nailon).
- Përdorni përpara oxhakut mbrojtësen kunder xixave.
- Mos e mbuloni dritat me letra dhe stufa.
- Hiqeni prizën e antenës gjatë shkretimave.
- Mbyllni televizorin me interrutorin dhe jo vetëm me telekomanden.
- Mos e vini televizorin afër mobiljeve që digjen lehtë ose brënda një mobilje.
- Mos pini duhan në krevat ose në kolltuk rrezikoni që të flini gjum.
- Nëse keni mundësi mbani në shtëpi një estintor.

Attenti  
a quei due!





## Për të ditur më shumë

Në çdo Aziende USL është prezent referenti lokal i planit të rajonit që merret me parashikimin e aksidenteve me zjarr në shtëpi.

Për të ditur ku mund ta kontaktoni, por edhe për të marr informacione për planin e rajonit telefononi.

I vetmi numër jeshil i shërbimit shëndetsor të rajonit Emilia-Romagna

**NumeroVerde**  
**800 033033**

çdo ditë nga e hëna deri të premten nga ora 8,30 deri në orën 17,30 dhe të shtunën nga ora 8,30 deri në orën 13,30.

**Coordinamento redazionale ed editoriale:** Marta Fin  
(Agenzia informazione e Ufficio stampa della Giunta regionale)

**Redazione:** Marinella Natali, Adele Ballarini  
(Servizio sanità pubblica, Regione Emilia-Romagna),  
Laura Vicinelli (Azienda Usl di Bologna),  
Serena Lanzarini (Azienda Usl di Imola)

**Grafica:** Tracce - Modena

**Stampa:** Ottobre 2011

Le illustrazioni sono tratte dal filmato "Attenti a quei due!" visibile su [www.saluter.it](http://www.saluter.it)

